KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

BOTIMI NR.23

Buletini mujor

Tetor 2026



Evidentohen mangësi në kontrollin e cilësisë dhe sigurisë së drithërave nga importi te konsumatori

Sistemi i kontrollit për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së drithërave nuk ka funksionuar plotësisht në mënyrë efektive në të gjitha hallkat e zinxhirit, nga importi deri te konsumatori. Gjatë periudhës 2020-2025 në vendin tonë janë importuar mesatarisht rreth 427,422 tonë drithëra të ndryshme. Për nga sasia e importuar, peshën më të madhe e zënë gruri për konsum njerëzor dhe misri për ushqimin e kafshëve. Shumica e drithërave të importuara e ka origjinën nga vende jashtë Bashkimit Evropian, ku Serbia renditet e para.

Për shkak të rëndësisë që drithërat dhe produktet e tyre kanë në konsumin e përditshëm të popullsisë, si dhe të risqeve që shoqërojnë sektorin, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në zbatim të Programit të Auditimit 2026, kreu auditimin e performancës me temë "*Kontrolli i cilësisë, magazinimi dhe importimi i drithërave (me fokus miellin)*". Auditimi shqyrtoi funksionimin e sistemit të kontrollit për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së drithërave dhe miellit, si dhe të proceseve të magazinimit dhe importimit, për periudhën 2020-2025. Në fokus ishte mënyra se si institucionet përgjegjëse ushtrojnë kontroll përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor, nga importi në Pikat e Inspektimit Kufitar, marrja dhe analizimi laboratorik i mostrave, inspektimi në terren i operatorëve të biznesit ushqimor, deri te magazinimi, përpunimi, tregtimi dhe konsumatori final. Subjektet kryesore të auditimit ishin Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, strukturat e tij rajonale dhe laboratorike, si dhe autoritetet doganore, në funksion të rolit të tyre në kontrollin dhe zhdoganimin e produkteve ushqimore të importuara.

Në përfundim të auditimit, KLSH konstatoi se sistemi aktual i kontrollit ofron garanci të pjesshme, por jo të mjaftueshme, për monitorimin e vazhdueshëm, të koordinuar, të gjurmueshëm dhe të bazuar në risk të cilësisë dhe sigurisë së drithërave dhe miellit përgjatë gjithë zinxhirit ushqimor.

Mangësitë e konstatuara nuk kufizohen në një hallkë të vetme, por shfaqen si dobësi të ndërlidhura ndërmjet kontrollit në kufi, analizimit laboratorik dhe inspektimit në terren. Për rrjedhojë, sistemi ka kapacitet të reagojë në raste të caktuara, por ende nuk garanton plotësisht një qasje parandaluese, të integruar dhe të mbështetur në evidenca.

Auditimi evidentoi problematika në planifikimin dhe realizimin e inspektimeve me bazë risku, mbulimin e kufizuar të operatorëve të licencuar, dokumentimin e pamjaftueshëm të praktikave inspektuese, mungesën e gjurmës së plotë të auditimit, si dhe kapacitetet e kufizuara njerëzore, teknike, laboratorike dhe financiare, të cilat kanë ndikuar në aftësinë e institucioneve përgjegjëse për të identifikuar, monitoruar dhe adresuar në kohë risqet kryesore të sektorit të drithërave dhe miellit. Një tjetër problematikë lidhet me mungesën e manualeve sektoriale specifike për drithërat dhe miellin, përdorimin e listave të përgjithshme të verifikimit dhe mospërditësimin e plotë të kuadrit kombëtar në përputhje me zhvillimet më të fundit të "acquis-it" të Bashkimit Evropian. Këta faktorë kanë ndikuar në standardizimin e pamjaftueshëm të praktikave të kontrollit.

Sistemi i kontrollit të cilësisë së drithërave



Në vend ekziston një kuadër ligjor, institucional dhe procedural për kontrollin e drithërave dhe miellit, si dhe struktura përgjegjëse për zbatimin e tij. Megjithatë, ekzistenca formale e këtij sistemi nuk është përkthyer plotësisht në një mekanizëm kontrolli të integruar, efektiv, të koordinuar, parandalues dhe të bazuar në risk.
Kontrolli zyrtar mbështetet në tri hallka kryesore: kontrollin në Pikat e Inspektimit Kufitar, verifikimin laboratorik dhe inspektimin në terren. Në praktikë, këto hallka nuk kanë funksionuar gjithmonë si pjesë e një sistemi të vetëm të ndërlidhur, duke krijuar boshllëqe në gjurmueshmëri, në shkëmbimin e informacionit, në dokumentimin e kontrolleve dhe në përdorimin e evidencave për vendimmarrje.

INSPEKTIMET NË TERREN

Në hallkën e inspektimit në terren, auditimi konstatoi se procedurat inspektuese kanë funksionuar më shumë si veprimtari formale dhe operative sesa si instrument i plotë parandalues për administrimin e risqeve të sektorit. Nga 478 inspektime të realizuara në fushën e drithërave dhe miellit, gjatë periudhës 2020-2025, një pjesë e konsiderueshme janë kryer jashtë planit, çka tregon një prirje të lartë reaguese dhe jo një mbulim të qëndrueshëm, të planifikuar dhe të orientuar nga risku.
Referuar të dhënave nga AKU, për periudhën 2020-2025, janë inspektuar në total rreth 112 biznese në fushën e drithërave dhe miellit. Megjithatë, nga 56 operatorë të biznesit ushqimor të licencuar në këtë fushë, vetëm 18 prej tyre rezultojnë të jenë inspektuar. Konkretisht, vetëm 32% e tyre janë mbuluar me inspektim, ndërkohë që 38 subjekte, ose rreth 68%, nuk janë inspektuar asnjëherë.
Në praktikën e inspektimeve të kryera nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në portalin e-inspektimi, inspektorët e AKU-së nuk dokumentojnë punën inspektuese në terren sipas kërkesave specifike të procesit inspektues dhe manualit të inspektimit. Në praktikë, inspektorët e AKU-së, dokumentojnë vetëm ato procese inspektimi të cilat rezultojnë me shkelje (masa administrative). Referuar të dhënave të inspektimeve në fushën e drithërave dhe të miellit, nga totali i 478 inspektimeve të kryera, vetëm 113 inspektime (ose 23.6%) kanë rezultuar me masa administrative, pra me dokumentim. Gjatë kësaj periudhe 5-vjeçare, AKU ka evidentuar vetëm 1 rast me problematika në lidhje me gjurmueshmërinë, 4 raste me problematika në etiketim dhe asnjë rast të konstatuar përzierje të drithërave apo miellit.

MONITORIMI LABORATORIK

Në hallkën laboratorike, auditimi konstatoi se kapacitetet ekzistuese të AKU-së nuk garantojnë plotësisht analizimin e të gjithë treguesve të nevojshëm për vlerësimin e sigurisë dhe cilësisë së drithërave dhe miellit. Sistemi laboratorik paraqet mangësi në drejtim të akreditimit sipas standardit ISO/IEC 17025, infrastrukturës, sigurisë laboratorike, pajisjeve, reagjentëve, metodave të analizimit dhe gamës së analizave të kryera. Këto kufizime kanë rëndësi të veçantë, pasi një pjesë e risqeve kryesore të drithërave dhe miellit, si: mykotoksinat, metalet e rënda, mbetjet e pesticideve dhe kontaminues të tjerë, nuk mund të identifikohen përmes kontrollit vizual apo dokumentar, por kërkojnë verifikim analitik të specializuar dhe të besueshëm. Bazuar në informacionin e AKU-së, gjatë periudhës 2020-2025, laboratorët rajonalë kanë kryer analiza, kryesisht fiziko-kimike dhe fitosanitare, për drithërat dhe produktet e tyre, të fokusuara në tregues të cilësisë, si: lagështia, aciditeti, hiri, gluteni, poroziteti dhe papastërtitë fitosanitare.
Nga 4893 mostra të bukës dhe miellit të analizuara në laboratorët e AKU-së, vetëm 12 mostra kanë rezultuar jokonforme, kryesisht për shkak të pranisë së insekteve, larvave, parazitëve, papastërtive fitosanitare, si dhe tejkalimeve të treguesve të lagështisë dhe aciditetit. Në shumë raste, analizat nuk janë kryer për shkak të mungesës së reagentëve, mosfunksionimit të pajisjeve ose mungesës së tyre. Si pasojë, janë evidentuar ndërprerje të herëpashershme dhe, në disa raste, pamundësi e plotë për kryerjen e analizave mikrobiologjike. Grupi i auditimit evidentoi një hendek të konsiderueshëm ndërmjet kërkesave ligjore, përditësimit të kuadrit rregullator dhe kapaciteteve reale laboratorike për monitorimin dhe analizimin e mykotoksinave në drithëra. Kuadri rregullator dhe sistemi i monitorimit të drithërave në vend nuk garantojnë analizimin e plotë të kontaminuesve kryesorë që ndikojnë në sigurinë ushqimore. Analizimi i drithërave nuk përfshin në mënyrë të plotë disa tregues kritikë të kontaminimit, si metalet e rënda (përfshirë nikelin) dhe mikotoksinat T-2, HT-2 etj., të cilët nuk analizohen në asnjë laborator në Shqipëri. Gjithashtu, nuk janë reflektuar plotësisht përditësimet e fundit të BE-së për nivelet e lejuara të disa kontaminuesve dhe për kategori të caktuara të produkteve me bazë drithërat.

KONTROLLI NË KUFI

Në hallkën e importit dhe kontrollit në Pikat e Inspektimit Kufitar (PIK), u konstatua se mekanizmat ekzistues paraqesin mangësi në gjurmueshmërinë e proceseve, shkëmbimin e informacionit, standardizimin e verifikimeve, infrastrukturën dhe kapacitetet teknike. Kontrolli dokumentar realizohet kryesisht në mënyrë shkresore dhe jo përmes një sistemi elektronik të integruar, i cili të mundësojë administrimin e plotë të praktikës së importit dhe ndërlidhjen në kohë reale ndërmjet AKU-së, PIK-ve, strukturave rajonale dhe autoriteteve doganore. Mungesa e një mekanizmi të tillë e bën më të vështirë ndjekjen e ngarkesës nga hyrja në kufi deri te destinacioni përfundimtar, veçanërisht në rastet kur kërkohet bllokim, marrje mostre, pritje e rezultatit laboratorik apo ndjekje e produktit në magazinën e operatorit. Gjithashtu, nuk rezultojnë të jenë të standardizuara plotësisht procedurat për verifikime të kryqëzuara ndërmjet certifikatave shoqëruese, dokumenteve doganore, deklaratave të importit, rezultateve laboratorike dhe karakteristikave fizike të ngarkesës. Inspektorët disponojnë mjete minimale për marrjen e mostrave dhe nuk kanë pajisje të mjaftueshme për matjen e parametrave fizikë si lagështia dhe temperatura. Këto mangësi kufizojnë aftësinë e kontrollit kufitar për të vepruar si filtër parandalues ndaj produkteve me risk përpara hyrjes së tyre në tregun e brendshëm.



KLSH-SIGMA, takime pune për rishikimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë

Në kuadër të procesit të rishikimit të Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, në datat 30 shtator dhe 1 tetor 2026, në ambientet e Kontrollit të Lartë të Shtetit u zhvilluan takime pune me përfaqësues të SIGMA-s, z. Alastair Swarbrick dhe znj. Lelde Dimante.

Në këto takime morën pjesë anëtarët e grupit të punës të ngritur për rishikimin e Manualit dhe drejtues të departamenteve të auditimit.

Grupi i punës për rishikimin e Manualit, i përbërë nga audituesë me eksperiencë në auditimin e përputhshmërisë, u njoh dhe diskutoi në mënyrë të detajuar sugjerimet e ekspertëve të SIGMA-s mbi aspektet e Manualit që kërkojnë rishikim.

Diskutimet u fokusuan në forcimin e karakterit praktik dhe udhëzues të Manualit, si dhe në përditësimin e kërkesave të standardeve ndërkombëtare, gjatë planifikimit, kryerjes, dokumentimit dhe raportimit të auditimeve të përputhshmërisë. Në përfundim, u dakordësua vijimi i komunikimit dhe bashkërendimit me përfaqësuesit e SIGMA-s gjatë procesit, me qëllim reflektimin e çështjeve të evidentuara në versionin e rishikuar të Manualit. Ky bashkëpunim me SIGMA-n mbështet angazhimin e KLSH-së për përmirësimin e vazhdueshëm të metodologjisë së auditimit, rritjen e cilësisë së punës audituese dhe zbatimin e standardeve ndërkombëtare në praktikë.

KLSH, pjesë e programit të certifikimit nga CEF dhe CIPFA mbi "Menaxhimin e Aktiveve të Sektorit Publik"

Në datat 12–16 tetor 2026, u zhvillua në Lubjanë, Sllloveni, programi i certifikimit mbi menaxhimin e aktiveve të sektorit publik "*Asset Management Certification Programme*", i organizuar nga Qendra e Ekselencës në Financë (CEF), në bashkëpunim me Institutin e Certifikuar për Financat Publike dhe Kontabilitetin (CIPFA) dhe ekspertë ndërkombëtarë e rajonalë. Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mori pjesë Klaudio Halili, auditues.

Ky program zhvillohet në kuadër të nismës "*Empowered Accountants and Auditors for Accountable Public Sector* (EAPS)", me fokus menaxhimin e aktiveve të qëndrueshme të sektorit publik. Programi synon të ndërthurë standardet dhe praktikat ndërkombëtare me specifikat e vendeve të Evropës Juglindore dhe Lindore, në funksion të përmirësimit të administrimit dhe përdorimit të pasurisë publike.

Gjatë zhvillimit të programit u trajtuan çështje që lidhen me qeverisjen dhe organizimin e menaxhimit të aktiveve, rëndësinë e përcaktimit të përgjegjësive institucionale dhe bashkëpunimit ndërmjet strukturave të ndryshme, si dhe mënyrën e organizimit të shërbimeve përgjegjëse për administrimin e pronës publike. Vëmendje e veçantë iu kushtua qasjeve të CIPFA-s për hartimin e dokumentacionit të menaxhimit të aktiveve, përfshirë politikat, strategjitë dhe planet e veprimit, në përputhje me qëllimet, prioritetet dhe objektivat e institucionit.



Një tjetër çështje e rëndësishme ishte menaxhimi i performancës së aktiveve, vlerësimi i vlerës sociale që ato krijojnë, si dhe përdorimi i sistemeve të informacionit për mbledhjen, administrimin dhe raportimin e të dhënave. Në këtë kuadër, u theksua rëndësia e krijimit dhe mirëmbajtjes së regjistrave të plotë dhe të saktë të aktiveve të sektorit publik, si një element thelbësor për rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit në administrimin e pronës publike. Pjesë e programit ishte edhe trajtimi i parimeve të njohjes, matjes dhe raportimit financiar të aktiveve të sektorit publik, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (IPSAS).

Forcimi i bashkëpunimit brenda Rrjetit të SAI-ve të vendeve kandidate për në BE



Forcimi i pavarësisë institucionale, zhvillimi i kapaciteteve të auditimit dhe rritja e ndikimit të auditimit të jashtëm publik ishin temat kryesore të trajtuara gjatë takimit të drejtuesve të Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI) nga vendet kandidate dhe kandidate të mundshme për anëtarësim në BE, të mbajtur më 15-16 tetor 2026, në Paris, Francë. Takimi u organizua nga SIGMA në bashkëpunim me Zyrën Shtetërore të Auditimit të Maqedonisë së Veriut dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë. Gjatë aktivitetit u miratua edhe Plani i Punës së Rrjetit 2027-2028, u shkëmbyen përvoja dhe u diskutuan sfidat e përbashkëta të Institucioneve Supreme të Auditimit.

Pjesëmarrësit diskutuan gjithashtu edhe mbi disa tema strategjike me rëndësi për SAI-t, duke përfshirë ndikimin që ka në auditim lidershipi, mbrojtjen e pavarësisë institucionale dhe forcimin e kapaciteteve të auditimit në lidhje me projektet e investimeve publike dhe reformat që lidhen me BE-në.

Kontributet nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t (IDI), SIGMA dhe SAI-t pjesëmarrëse, nxitën diskutime të pasura mbi mënyrën se si SAI-t mund të rrisin efektivitetin, qëndrueshmërinë dhe ndikimin e tyre në një mjedis qeverisjeje gjithnjë e më kompleks. Gjatë takimit, Presidentët e SAI-ve ndanë përvoja, sfida dhe praktika të mira nga institucionet e tyre përkatëse duke nxjerrë në pah vlerën e shkëmbimit të informacioneve ndërmjet kolegëve, bashkëpunimin rajonal në mbështetjen e SAI-ve për t'u përballur me sfidat e auditimit dhe për të kontribuar në një llogaridhënie dhe qeverisje publike më të fortë. Takimi përforcoi angazhimin e përfaqësues të institucioneve që marrin pjesë në Aktivitetet e Zhvillimit të EUROSAI-t (EDA), për bashkëpunim të vazhdueshëm, shkëmbim të njohurive dhe zhvillim të kapaciteteve, duke i ndihmuar SAI-t të kryejnë auditime me cilësi të lartë dhe të forcojnë llogaridhënien e sektorit publik në të gjithë rajonin.



Takimi vjetor i Komitetit të Kontaktit të SAI-ve të BE-së

Gjykata Franceze e Llogarive (Cour des Comptes) organizoi në datat 13-14 tetor 2026 takimin vjetor të Komitetit të Kontaktit me temë: "*Tranzicioni i gjelbër, një domosdoshmëri për forcimin e ekonomisë dhe autonomisë strategjike të BE-së*". Në këtë aktivitet, Kontrolli i Lartë i Shtetit u përfaqësua nga znj. Xhesila Nano dhe znj. Laura Lila, duke iu bashkuar përfaqësuesve të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe ekspertëve evropianë e ndërkombëtarë në diskutimet mbi sfidat dhe perspektivat e tranzicionit të gjelbër.

Takimi trajtoi çështje me rëndësi strategjike për Bashkimin Evropian, përfshirë tranzicionin energjetik, ekonominë qarkulluese, bujqësinë, pyjet dhe menaxhimin e ujit. Gjithashtu, u diskutua roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në vlerësimin e politikave publike, përdorimin efektiv të fondeve dhe promovimin e praktikave të mira në mbështetje të objektivave mjedisorë dhe klimatikë. Një pjesë e rëndësishme e programit iu kushtua shkëmbimit të përvojave ndërmjet institucioneve pjesëmarrëse dhe prezantimit të praktikave konkrete të auditimit që kontribuojnë në përmirësimin e qeverisjes, llogaridhënies dhe efektivitetit të ndërhyrjeve publike në fushën e tranzicionit të gjelbër. Përmes këtij aktiviteti u theksua rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe e shkëmbimit të njohurive për forcimin e rolit të auditimit publik në mbështetje të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të objektivave strategjikë të Bashkimit Evropian.

Vizita studimore në kuadër të projektit rajonal të UNDP-së “Smart Finance” për qeverisjen vendore

Identifikimi në kohë i rreziqeve me të cilat përballen autoritetet vendore në prokurimin publik, si dhe parandalimi i parregullsive, kërkojnë mekanizma efektivë kontrolli, bashkëpunim të fortë institucional dhe shkëmbim të informacionit në kohën e duhur.

Këto çështje ishin në qendër të një vizite studimore rajonale që u zhvillua në Bratislla vë të Sllovakisë, nga data 7-9 tetor 2026 në kuadër të projektit rajonal të UNDP-së “*Smart Finance*” për një qeverisje vendore të përgjegjshme.

Vizita mblodhi së bashku rreth 50 pjesëmarrës nga Shqipëria, Sllovakia, Bosnjë-Hercegovina, Moldavia, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, për të shkëmbyer përvoja mbi auditimin e financave publike.

Në fokus të vizitës ishte trajtimi i çështjeve lidhur me “financat inteligjente” për një qeverisje vendore të përgjegjshme. Pjesëmarrësit u njohën me mekanizmat dhe praktikat e përdorura nga Republika e Sllovakisë për mbikëqyrjen dhe parandalimin e parregullsive, si dhe shqyrtimin e mundësive për përshtatjen dhe zbatimin e përvojave përkatëse në nivel kombëtar dhe vendor.



Disa nga tematikat e trajtuara gjatë vizitës përfshin auditimin e performancës dhe auditimin e OZHQ-ve me fokus të veçantë në nivelin vendor; menaxhimi i mbetjeve bashkiake, përdorimi i të dhënave dhe mjeteve digjitale në procesin e auditimit, si dhe mbikëqyrja dhe garantimi i integritetit në prokurimin publik. Gjatë vizitës, pjesëmarrësit u njohën me aplikacionin “MuMap” (Municipalities on Map), një mjet inovativ i zhvilluar nga SAI i Sllovakisë, për planifikimin e auditimeve dhe vlerësimin e risqeve.

Aplikacioni mundëson përdorimin sistematik të të dhënave për identifikimin e fushave me risk dhe orientimin e burimeve të auditimit aty ku nevoja për ndërhyrje është më e madhe. Projekti kontribuon në forcimin e kapaciteteve institucionale për menaxhimin transparent, të përgjegjshëm dhe efikas të burimeve publike. Nga KLSH në këtë vizitë studimore morën pjesë audituesit Artan Vokshi dhe Artur Cengu, pjesë e Departamentit të Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore dhe Pronës Publike.

Workshop-i “Digjitalizimi i shoqërisë dhe roli i SAI-ve”

Në datat 29 shtator-1 tetor 2026, u zhvillua në Hagë workshop-i me temë “*Digjitalizimi i shoqërisë dhe roli i SAI-ve*“, organizuar nga Gjykata e Llogarive e Holandës në kuadër të programit “Constituency Programme”, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Gjatë workshop-it u trajtua procesi i digjitalizimit në vendet e Ballkanit Perëndimor, bazuar në studime ekonomike dhe në krahasim me treguesit kryesorë të përdorur nga Bashkimi Evropian. Një vëmendje e veçantë iu kushtua rolit të Institucioneve Supreme të Auditimit në mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë përmes digjitalizimit, si dhe mundësive për të kontribuar në përmirësimin e politikave dhe shërbimeve publike digjitale.

Programi përfshiu prezantime nga ekspertë të fushës, diskutime tematike, raste studimore dhe shkëmbim përvojash ndërmjet vendeve pjesëmarrëse. Ndër çështjet kryesore të trajtuara ishin zhvillimet në fushën e Inteligjencës Artificiale dhe transformimit digjital, siguria kibernetike, varësia teknologjike nga prodhues apo shtete të caktuara, zhvillimi i sistemeve të mëdha teknologjike dhe sfidat që lidhen me përdorimin e teknologjive të reja.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet krijoi mundësi për zgjerimin e njohurive profesionale dhe njohjen me praktika e qasje të ndryshme në auditimin e proceseve të digjitalizimit.



Në këtë kuadër, u evidentua rëndësia e orientimit të veprimtarisë audituese drejt vlerësimit jo vetëm të përputhshmërisë së përdorimit të fondeve publike, por edhe të efektivitetit, sigurisë dhe qëndrueshmërisë së investimeve në teknologji dhe shërbime digjitale.

Në përfundim të aktivitetit, u theksua nevoja që Institucionet Supreme të Auditimit të luajnë një rol aktiv në mbikëqyrjen e transformimit digjital, përmes identifikimit të risqeve, vlerësimit të rezultateve dhe ofrimit të rekomandimeve që mbështesin inovacionin dhe përmirësimin e shërbimeve publike.

KLSH u përfaqësua në këtë workshop nga znj. Joniada Goçaj, z. Rigels Guzi dhe znj. Alketa Çobo.

“E vërteta përtej shifrave”, nga gjetjet e auditimit te llogaridhënia publike për qytetarët

Në kuadër të projektit “*E vërteta përtej shifrave*”, Faktoje organizoi më 6 tetor 2026 tryezën e diskutimit e cila kishte në fokus si mund të kthehen gjetjet e auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit në informacion të kuptueshëm dhe në mekanizma konkretë llogaridhënieje për qytetarët.
Gjatë aktivitetit u prezantua dokumenti i politikave “*Nga gjetjet e auditimit te llogaridhënia publike përmes rolit të medias në Shqipëri*”, i cili analizon rolin e medias në shpjegimin e gjetjeve të auditimit për publikun dhe në ndjekjen e rekomandimeve pas publikimit të raporteve.
Diskutimet u përqendruan te gjetjet dhe rekomandimet për KLSH-në, Kuvendin, median, gazetarët dhe shoqërinë civile, me synim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet tyre, ndjekjen e rekomandimeve të auditimit dhe rritjen e llogaridhënies për përdorimin e fondeve publike. Në tryezë morën pjesë përfaqësues të trupit diplomatik, KLSH-së, institucionesh publike, deputetë, ekspertë, gazetarë etj.
Drejtoresha ekzekutive e Faktoje-së, znj. Klodiana Kapo, theksoi rëndësinë e bërjes së raporteve të auditimit pjesë të debatit publik, duke nënvizuar se ato nuk mund të qarkullojnë vetëm brenda institucioneve.
Ambasadorja e Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Marleen Monster, vendi i së cilës mbështet projektin “*E vërteta përtej shifrave*”, u ndal te nevoja e interpretimit dhe komunikimit të të dhënave për publikun: *“Numrat nuk flasin vetë, dikush duhet t’i lexojë, t’i shpjegojë dhe t’i kthejë në pyetje të vështira”.*



Nga ana e KLSH-së, kryeaudituesja Xhuljeta Çelaj foli për bashkëpunimin me Kuvendin dhe marrëdhënien me median, duke theksuar rëndësinë e citimit profesional të raporteve të auditimit dhe të ruajtjes së kontekstit në të cilin paraqiten gjetjet.
Mesazhi kryesor i tryezës ishte i qartë: Auditimi nuk përfundon me publikimin e raportit. Gjetjet marrin vlerë për qytetarët kur shifrat shndërrohen në informacion të kuptueshëm, rekomandimet ndiqen dhe përgjegjësia institucionale bëhet e matshme. Nisma synon të rrisë ndikimin publik të auditimit, duke i kthyer gjetjet në informacion të kuptueshëm dhe të dobishëm për qytetarët, si dhe të nxisë reforma në politikat publike.

MESAZHE SOLIDARITETI





Falëminderit për leximin!

© **Të gjitha të drejtat e rezervuara nga KLSH**

www.klsh.org.al
E-mail: klsh@klsh.org.al
info@klsh.org.al
Kontrolli i Lartë i Shtetit
klsh_org_al
(KLSH) Albanian Supreme Audit Institution
Rruga “Abdi Toptani” Nr.1 Tiranë
Orari pritjeve për publikun:
E hënë – E enjte: 08:00 – 16:30
E premte: 08:00 – 14:00